



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar””. (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Raja dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Albana Shkurta – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Mamica Dhamo – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Hapim mbledhjen.

Sot në rendin e ditës të punës së komisionit kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar””.

Të pranishëm në komision kemi: zonjën Albana Shkurta, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë dhe zonjën Mamica Dharmo, specialiste, të cilave u uroj mirëseardhjen në komision.

Dua t’u jap fjalën përfaqësuesve të Ministrisë për të na prezantuar ndryshimet e propozuara. Pastaj jemi të detyruar të presim Komisionin e Ligjeve për të reflektuar të gjitha komentet, sugjerimet apo vërejtjet që ata kanë. Pasi të bëhen shpjegimet, do të kalojmë te pyetje-përgjigjet, në fund do të kalojmë te diskutimet.

A jeni dakord me këtë rend dite? Dakord.

Zonja Shkurta, fjala është për ju.

Albana Shkurta – Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”” synon harmonizimin me legjislacionin europian të fushës së mbrojtjes së konsumatorëve.

Projektligji është plotësisht i përputhshëm me direktivën nr. 83/2011 për të drejtat e konsumatorit, si dhe pjesërisht i përputhshëm me direktivën nr. 11/2013 për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve.

Ky projektligj synon, gjithashtu, përcaktimin e rregullave për informimin e konsumatorëve për shitjen dhe shërbimet që ofrohen në treg, për vendosjen e ekuilibrave të drejtë në ekonominë e lirë të tregut dhe shmangien e deformimeve apo mangësive të tregut të mallrave dhe shërbimeve që ofrohen ndaj publikut të gjerë. Ky informim konsiderohet mjaft i rëndësishëm për të fuqizuar konsumatorët në treg, për t’u mundësuar atyre një vendimmarrje të informuar dhe të ndërgjegjshme për përmbushjen sa më të mirë dhe plotë të interesave të tyre.

Detyrimi për informacion që ky projektligj vendos mbi tregtarët minimizon asimetrinë e informacionit që ndeshet ndërmjet dy palëve, asaj të mirinformuar për shërbimet dhe mallrave që ofron, tregtarëve, dhe palës që nuk ka të njëjtat mundësi, konsumatorëve. Projektligji parashikon dispozita për detyrimin për informacion dhe elementet që informacioni duhet të përmbushë për të

gjitha llojet e kontratave konsumatore, duke përfshirë edhe kontratat e lidhura në largësi apo jashtë qendrave të tregtimit. Ky informacion konsiston në karakteristikat kryesore, në çmimin e plotë të produktit apo shërbimit, identitetin e tregtarit, rregullimet për pagesën, garancitë, afatin, funksionalitetin në rastet e përmbajtjes dixhitale dhe të drejtën e heqjes dorë për sa u takon kontratave në largësi apo jashtë qendrave të tregtimit etj.

Aspekti tjetër shumë i rëndësishëm i këtij projektligji lidhet me zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve nga struktura jashtëgjyqësore, të cilat ofrojnë procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve të paanshme, transparente, efektive dhe të drejta.

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara në projektligj sigurojnë funksionimin e disa strukturave për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të veçanta për sektorët e shërbimeve të interesit publik, si energji, telekomunikacion, furnizim me ujë etj., si dhe një strukturë të posaçme për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve që përmbledh sektorët e mbetur të pambuluar.

Ky opsion siguron edhe kosto më të ulëta për krijimin dhe funksionimin e një sistemi të zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve. Në ligjet specifike të shërbimeve me interes publik përcaktohen dispozita që adresojnë mosmarrëveshjet e operatorëve të biznesit me konsumatorët. Pra, janë marrë përsipër funksionet e zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve nga entet rregullatore përkatëse. Sipas direktivave europiane, të cilat kanë transpozuar këto ligje përkatësisht, kërkohet respektimi apo vënia e tyre nën një linjë me parimet e direktivës nr. 11/2013 për mosmarrëveshjet ndërmjet konsumatorëve dhe ofruesve të produkteve e shërbimeve.

Në këtë këndvështrim, projektligji plotëson dhe përmirëson legjislacionet specifike, duke sjellë përmirësimin e mëtejshëm të funksioneve të zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve, pa cenuar funksionin e tyre në vetvete, por duke garantuar të drejtat e konsumatorit që rrjedhin nga ky kuadër ligjor. Gjithashtu, nuk krijohen kosto shtesë për këto ente.

Pika tjetër, e cila është gjithashtu e rëndësishme, ka të bëjë me dispozitat, të cilat bëjnë shtrirjen e mbrojtjes së konsumatorëve në nivel vendor nëpërmjet delegimit të disa kompetencave të pushtetit vendor për mbrojtjen e konsumatorëve të lidhura kryesisht me informimin, ndërgjegjësimin, mbledhjen dhe seleksionimin e ankesave të tyre në bashkëpunim të ngushtë me strukturën përgjegjëse të mbrojtjes së konsumatorëve në nivel qendror.

Në lidhje me raportin e projektligjit me Kodin Civil, sqarohet se dispozitat e ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve, si një ligj i posaçëm, i cili ofron rregullimin e kontratave me subjekte të posaçme konsumatorit dhe tregtarit, rrjedhin dhe devijojnë nga rregullimet e përgjithshme tradicionale të Kodit Civil, të bazuara në lirinë kontraktore.

Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve në arkitekturën legislative qëndron si ligj i posaçëm ndaj ligjit të përgjithshëm, që është Kodi Civil.

Duke pasur një ligj të posaçëm për mbrojtjen e konsumatorëve bëhet e mundur që të gjitha këto ndryshime, të cilat rrjedhin si pasojë e direktivave apo ndryshimeve në to, të diktuar nga Bashkimi Europian, të prekin ligjin e posaçëm dhe jo Kodin Civil. Këto janë elementet kryesore që përmban ky projektligj. Jam në dispozicion të pyetjeve tuaja.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Shkurta!

Po, zonja Gjermeni.

Eglantina Gjermeni - Faleminderit, kryetar!

Së pari, dua ta përgëzoj dhe ta falënderoj zëvendësministren për prezantimin, por edhe për projektligjin, që, në fakt, përafrohet shumë me legjislacionin e Bashkimit Europian dhe, konkretisht, me disa prej direktivave.

Lexova me vëmendje relacionin dhe projektligjin, pashë që kishte disa ndryshime teknike, prandaj dua t'ju bëj dy-tri pyetje.

Pyetja e parë është: çfarë përfiton konsumatori shqiptar nga ky ndryshim në këtë projektligj, i shtohen të drejtat apo ka më shumë mundësi apo alternativa për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet?

Pyetja e dytë lidhet me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, konkretisht të shoqatave të konsumatorëve apo organizatave të tjera të shoqërisë civile dhe institucioneve që mbrojnë të drejtat e konsumatorëve: a janë përfshirë sugjerimet e tyre dhe janë marrë në konsideratë në projektligjin që ju keni sjellë? Në fund të relacionit ishin disa emra organizatash ndërkombëtare dhe lokale, por dua të di nëse kanë qenë pjesë e të gjithë procesit të hartimit të këtij projektligji.

Pyetja e tretë ka të bëjë me mekanizmin e zbatimit të këtij ligji në momentin që miratohet. Duke qenë se projektligji është shumë afër legjislacionit të Bashkimit Europian, mendoj se është një ligj i avancuar dhe kam një vlerësim maksimal për punën e bërë. Jam e shqetësuar edhe për zbatimin e ligjeve në përgjithësi dhe dua të di nëse ju keni krijuar apo do të

krijoni mekanizma eficientë për të bërë të mundur zbatimin e këtij ligji në momentin që miratohet nga parlamenti.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Meqenëse jemi te pyetjet, a ka ndonjë pyetje nga kolegët? Jo, nuk ka. Atëherë fjala për ju!

Albana Shkurta – Faleminderit për pyetjet!

Për sa i përket pyetjes së parë, se çfarë përfiton konsumatori nga ky projektligj, sigurisht shtohen të drejtat që ka konsumatori ndaj tregtarëve, kryesisht për sa i përket standardizimit të disa rregullave, të cilat duhet të përfshihen patjetër në kontratat e shërbimit midis tregtarit dhe konsumatorit.

Projektligji synon harmonizimin dhe përputhjen 100% me direktivat e BE-së. Konsumatori në tregun europian ka disa standarde për sa i përket mënyrës sesi duhet të jetë ai paraprakisht i informuar në lidhje me produktet apo shërbimet që merr. Ky është një proces, i cili reflektohet ose standardizohet në kontratat që vendosen midis ofruesit të shërbimit, pra tregtarit, dhe konsumatorit. Të gjitha këto janë të paraqitura në projektligj.

Për sa u përket mundësive për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, aktualisht ne kemi një strukturë në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë që është e përbërë nga specialistë, kryesohet nga përgjegjësi i sektorit përkatës për mbrojtjen e konsumatorit, si dhe anëtarë, të cilët janë pjesëtarë nga Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Projektligji synon shtrirjen e mundësive për zgjidhjen alternative edhe në ato shërbime, të cilat aktualisht janë të rregulluara, siç janë energjia, telekomunikacioni apo uji. Në standardet apo kontratat që parashikon ofruesi i shërbimit për energji elektrike, telekomunikacion apo ujë brenda këtyre standardeve të rregulluara kanë aspekte, të cilat rregullojnë marrëdhënien midis ofruesit të shërbimit dhe konsumatorit për sa u takon mosmarrëveshjeve që mund të lindin, por ndërkohë projektligji synon që këto parashikime, që janë në dispozitat aktuale, të standardizohen dhe të jenë në përputhje me direktivën.

Konkretisht, një konsumator mund të bënte deri dhe një ankesë në lidhje me shërbimin që ka marrë për telekomunikacion, për shërbimin me ujë apo energji, ndërkohë që ky projektligji synon që këto procese të standardizohen, pra të futet nocioni i të pasurit i një formati standard se si administrohet ankesa, koha e trajtimit të ankesës, cilët janë përgjegjësit për shqyrtimin e kësaj

ankese, si dhe nxjerrja dhe publikimi i një vendimi për këtë ankesë. Këto janë disa risi, të cilat i trajton ky projektligj.

Sa i takon pikës së dytë për pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe organizatave të konsumatorëve, komisioni që unë ju përmenda për mbrojtjen e konsumatorit, i cili është ngritur pranë ministrisë, ka një faqe në internet ku publikohen të gjitha vendimet që merr ky komision.

Gjithashtu, aty publikohet kuadri ligjor, publikohen të gjitha shoqatat e konsumatorëve me adresat e tyre përkatëse në momentin që konsumatorët do të donin që t'i kontaktonin, si dhe anëtarë na këto shoqata janë pjesë e këtij komisioni.

Natyrisht, gjatë procesit të draftimit të projektligjit ministria është ndihmuar nga GIZ-i, ku me ndihmën e ekspertëve të GIZ-it është bërë procesi *screening* për të parë se cilat janë ndryshimet që ne duhet të parashikojmë në këtë projektligj për të synuar përputhshmërinë. Gjithashtu, procesi i konsultimit është bërë me të gjitha shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit dhe grupet e interesit.

Për sa i takon pikës së tretë, mekanizmi i zbatimit, është e vërtetë që projektligji synon përmirësime dhe një shtrirje pak më gjerë sa u takon sferave ku do të synohet që konsumatorit t'i jepet pak më tepër mundësi për t'u mbrojtur në raportin që ata kanë me ofruesit e produkteve dhe të shërbimeve. Aktualisht është parashikuar që në këto struktura, të cilat ekzistojnë paralelisht në entet përkatëse, aty ku ofrohen shërbime publike, siç janë Enti Rregullator i Energjisë, AKEP-i apo Enti Rregullator i Ujit, të ngrihen pranë tyre komisionet që do të trajtojnë ankesat përkatëse, ndërkohë që për të gjitha të tjerat do të vazhdojë të jetë komisioni pranë ministrisë.

Aktualisht komisioni pranë ministrisë trajton kërkesa, të cilat mund të paraqiten nga një individ, por ato merren në shqyrtim vetëm në ato raste kur ankesa presupozohet të ketë një shtrirje dhe një impakt pak më gjerë, pra prek më shumë konsumatorë sesa ai apo ajo që kanë paraqitur ankesën. Ndërkohë, direktiva e BE-së, prandaj ne kemi thënë që është pjesërisht e përputhur, parashikon ngritjen e një strukture të veçantë dhe të dedikuar gjë, të cilën, për të respektuar limitet buxhetore, ne e kemi parashikuar që duhet të ndodhë diku rreth vitit 2020 kur ne mund të jemi gati për ta ngritur si një strukturë të veçantë, por deri atëherë do të vazhdojë të mbulohet kështu siç është.

Për sa i përket mekanizmit të zbatimit një strukturë e veçantë dhe e dedikuar presupozohet të jetë shumë më aktive edhe sa u takon fushatave të ndërgjegjësimit për

konsumatorët me qëllim që t'i bëjë ata sa më të informuar, të ketë mundësinë e aktiviteteve promovuese, si dhe të organizimit të fushatave të ndryshme të kësaj natyre, por për momentin jemi në kuadrin e pasjes së një faqeje në internet, ku janë të publikuara të gjitha informacionet.

Gjatë çdo viti ne trajtojmë një numër të lartë kërkesash, të cilat publikohen në *website*.

Eduard Shalsi – Dakord.

Jemi në dijeni që Komisioni i Ligjeve është duke bërë disa ndryshime në projektligj. A mund të na bëni një përshkrim dhe një opinion të ndryshimeve që duan të bëjnë ata?

Majlinda Bozgo- Me Komisionin e Ligjeve kemi qenë në kontakt dhe jemi takuar, shqetësimi i tyre ka të bëjë me përplasjet që ligji ka me Kodin Civil, për sa kohë Kodi Civil mbulon kontratat e përgjithshme. Kemi rënë dakord që ligji i posaçëm i mbrojtjes së konsumatorëve të trajtojë kontratat e posaçme të konsumatorëve pa prekur dispozitat e Kodit Civil. Janë bërë edhe 2-3 ndryshime të tjera, por dua të them që kemi rënë dakord dhe ata kanë paraqitur një tabelë me komentet. Për secilin koment do të bëhet ndryshimi përkatës, por janë gjëra të vogla për të cilat kemi rakorduar në parim me Komisionin e Ligjeve.

Eduard Shalsi – Çfarë ndryshimesh ka konkretisht?

Majlinda Bozgo – Në fakt, diskutimi ishte i gjerë, por tani që kemi rakorduar, pak pika kanë mbetur, për shembull, është rasti ku thuhet që vendimi që merret në rastin e një zgjidhjeje të mosmarrëveshjeje detyruese, parashikohet në çfarë rastesh tregtari është në dijeni që duhet ta zbatojë patjetër dhe duhet të ketë penalitetin përkatës në rast se ai nuk e zbaton këtë vendim detyrues që merr struktura. Kjo u sqarua dhe u bë parashikimi përkatës.

Përdorimi i mjeteve të qëndrueshme, të cilat në ligjin e konsumatorëve është dhënë përkufizimi, u sqarua.

Gjithashtu, u vendos që, sa u takon marrëdhënieve midis tregtarëve dhe konsumatorëve, të zbatohen dispozita që ky projektligj ka parashikuar.

Eduard Shalsi – Ne jemi në kontakt edhe me komisionin.

A ka ndonjë pyetje?

Do të presim edhe opinionin e komisioneve të tjera, ne jemi komision përgjegjës.

Nesër kemi lënë një dëgjese me KESH-in, por për arsye se drejtori është i impenjuar bashkë me stafin e tij do ta spostojmë në një ditë tjetër.

Gjithashtu, nga një grup institucionesh kanë ardhur raportimet që kemi kërkuar për punën njëvjeçare të tyre. Kështu që do të programojmë për muajin tetor çfarë dëgjësash do të bëjmë. Materialet janë te sekretaria e komisionit.

Gjithashtu, rikujtoj se në datat 2 dhe 3 kemi vizitën e mbështetur nga OSBE-ja së bashku me Komisionin e Sigurisë për diskutimin për krimin mjedisor dhe çfarë propozimesh ka. Do ta zhvillojmë në Prespë dhe Korçë.

Në lidhje me mbledhjen e nesërme, jemi duke pritur një përgjigje nga 2-3 institucione të tjera. Mund të jetë diskutim për Kodin Ajror, vazhdon diskutimi për Kodin Ajror, ose ndonjë vizitë në ndonjë institucion tjetër.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA